LIGJ
Nr. 174/2014

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTABIT SUPREM TË FUQIVE ALEATE NË EUROPË (SHAPE) E SHTABIT TË KOMANDËS SUPREME ALEATE PËR TRANSFORMIMIN, NË PLOTËSIM TË PROTOKOLLIT TË PARISIT

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Europë (SHAPE) e Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin, në plotësim të Protokollit të Parisit.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 18.12.2014

Shpallur me dekretin nr. 8878, datë 30.12.2014 të Presidentit të Republikës Bujar Nishani

MARRËVESHJE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTABIT SUPREM TË FUQIVE ALEATE NË EVROPË (SHAPE) E SHTABIT TË KOMANDËS SUPREME ALEATE PËR TRANSFORMIMIN, NË PLOTËSIM TË PROTOKOLLIT TË PARISIT

PREAMBULË

Duke pasur parasysh Traktatin e Atlantikut Verior, të nënshkruar në Uashington D.C., më 4 prill 1949;

Duke pasur parasysh Marrëveshjen ndërmjet Palëve në Traktatin e Atlantikut Verior në lidhje me Statusin e forcave të tyre të nënshkruar në Londër më 19 qershor 1951;

Duke pasur parasysh Marrëveshjen ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut Verior dhe Shteteve të tjerë Pjesëmarrës në Partneritetin për Paqe në lidhje me Statusin e Forcave të tyre, të nënshkruar në Bruksel më 19 qershor 1995, dhe çdo Protokoll të tij në fuqi në territorin e Republikës së Shqipërisë;

Duke pasur parasysh Protokollin mbi Statusin e Shtabeve Ushtarake Ndërkombëtare të caktuar në pajtim me Traktatin e Atlantikut Verior, të nënshkruar në Paris më 28 gusht 1952;

Në njohje të autoritetit të Këshillit të Atlantikut Verior për të aktivizuar dhe deaktivizuar organet ushtarake të NATO-s me status ndërkombëtar;

Me dëshirën për të lidhur marrëveshje dhe masa shtesë për ngritjen, operimin dhe kushtet për personelin e caktuar në organet ushtarake të NATO-s që kanë statusin në bazë të Protokollit të Parisit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.;

Duke marrë në konsideratë se mund të lidhen marrëveshje të tjera me Shtetet që janë anëtare të

partneritetit dhe programeve të bashkëpunimit të NATO-s për të mbështetur aftësinë e shtetasve të këtyre Shteteve për të operuar ose funksionuar si një pjesë përbërëse e Forcave të drejtuara nga NATO-ja ose brenda një Shtabi Ushtarak Ndërkombëtare të NATO-s;

Duke pranuar që Këshilli i Atlantikut Verior mund të arrijë një vendim për të lidhur marrëveshje me Kombet e Bashkuara, Bashkimin Europian dhe organizata të tjera ndërkombëtare, organizata qeveritare, organizata joqeveritare, dhe organe ndërkombëtare ku këto organizata mund të marrin pjesë ose të mbështesin ndryshe mekanizmat, funksionet dhe aktivitetet e NATO-s që kanë status në bazë të Protokollit të Parisit dhe kësaj Marrëveshjeje Shtesë;

Dhe duke kuptuar që mund të kërkohen masa të mëtejshme zbatuese për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe për të realizuar kërkesat e mbështetjes;

Republika e Shqipërisë, nga njëra anë, dhe Komanda Supreme e Forcave Aleate në Evropë dhe Shtabi i Komandës Supreme Aleate për Transformimin, që më poshtë quhen Palët, në pajtim me paragrafin 2 të nenit 16 të protokollit, lidhin marrëveshjen e mëposhtme:

Neni 1
Përkufizime

Në këtë Marrëveshje (që më poshtë quhet "Marrëveshja Shtesë"), termi:

1. "Marrëveshje" nënkupton Marrëveshjen ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut Verior në lidhje me statusin e forcave të tyre, të nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951.
2. "Protokoll" nënkupton Protokollin mbi Statusin e Shtabeve Ushtarake Ndërkombëtare të ngritura në pajtim me Traktatin e Atlantikut Verior, të nënshkruar në Paris më 28 gusht 1952.
3. "PfP SOFA" nënkupton Marrëveshjen ndërmjet shteteve palë të Traktatit të Atlantikut Verior dhe shteteve të tjera që marrin pjesë në partneritetin për paqe në lidhje me statusin e forcave të tyre, të nënshkruar në Bruksel më 19 qershor 1995, duke përfshirë Protokollin Shtesë të kësaj Marrëveshjeje, të datës 19 qershor 1995, Protokollin tjetër Shtesë të datës 19 dhjetor 1997 dhe çdo Protokoll tjetër shtesë që hyn në fuqi në territorin e Republikës së Shqipërisë.
4. "SHAPE" nënkupton Komandën Supreme të Fuqive Aleate në Evropë.
5. "SACEUR" nënkupton Komandantin Suprem të Aleatëve në Evropë.
6. "HQ SACT" nënkupton Shtabin e Komandës Supreme Aleate për Transformimin.
7. "SACT" nënkupton Komandën Supreme Aleate për Transformimin.
8. "Shtab Suprem" nënkupton SHAPE ose HQ SACT, sipas rastit dhe siç përkufizohet në Protokoll, neni 1, si dhe çdo Shtab Suprem të ardhshëm ose organizatë pasuese.
9. "Shtab Aleat", si shtesë e Protokollit, neni 1, përfshin çdo organ ushtarak të NATO-s që, në pajtim me një vendim të Këshillit të Atlantikut Verior dhe siç parashikohet në një vendim të miratuar nga Këshilli i Atlantikut Verior të datës 19 maj 1969 mbi procedurat për aktivizimin dhe riorganizimin në kohë paqeje të organeve ushtarake të NATO-s dhe rregullat për dhënien atyre të statusit ndërkombëtar dhe financimit ndërkombëtar (C-M (69)22), i jepet statusi sipas Protokollit në pajtim me Protokollin, neni 14, dhe
10. Statusi që mbahet nga agjencitë e NATO-s rrjedh nga Marrëveshja e Otavës. Megjithatë, nëse Karta e Agjencisë së NATO-s vendos që personeli i asaj agjencie gëzon statusin sipas Protokollit të Parisit, kjo Marrëveshje Shtesë, pavarësisht paragrafit 9 të këtij neni, shtrihet mbi këtë personel të atashuar ose punësuar nga ajo Agjenci ose elementët e saj të varur në Republikën e Shqipërisë.
11. "Programet e partneritetit dhe bashkëpunimit të NATO-s" nënkupton të gjitha iniciativat e partneritetit dhe bashkëpunimit të NATO-s, bazuar në një raport gjeografik ose funksional, të aprovuar nga Këshilli i Atlantikut Verior.
12. "Organizatat ndërkombëtare qeveritare ose joqeveritare dhe organet ndërkombëtare" nënkupton ato organizata që marrin pjesë në aktivitetet e NATO-s nën kujdesin ose në mbështetje

të shtabeve aleate që gjenden ose operojnë ndryshe në ose nga territori i Republikës së Shqipërisë, nëse aprovohen nga Këshilli i Atlantikut Verior dhe që i raportohen rregullisht Republikës së Shqipërisë nga Shtabet përkatëse të Aleatëve.

13. "Kreu i një shtabi aleat" nënkupton titullarin e lartë përgjegjës, ushtarak ose civil, që në një moment të caktuar emërohet ose caktohet për të përfaqësuar një shtab aleat.

14. "Anëtarë" nënkupton:

a) Personelin e atashuar në një shtab aleat dhe që i përket shërbimeve të armatosura tokësore, detare ose ajrore të një shteti që është:

1) Palë në Traktatin e Atlantikut Verior;

2) Palë në PfP SOFA; ose

3) Merr pjesë në Programe të tjera partneriteti dhe bashkëpunimi të NATO-s.

b) Personelin civil që janë:

1) Shtetasit dhe të punësuar nga një palë në Traktatin e Atlantikut Verior dhe atashuar në një shtab aleat;

2) Shtetasit dhe të punësuar nga një palë në PfP SOFA dhe atashuar në shtabin aleat;

3) Shtetasit dhe të punësuar nga një shtet që merr pjesë në Programet e Partneritetit dhe Bashkëpunimit të NATO-s dhe të atashuar në një shtab aleat; ose

4) Shtetasit e një pale në Traktatin e Atlantikut Verior dhe të punësuar nga një Shtab i Aleatëve në kategoritë e përcaktuara nga NAC (Civilët Ndërkombëtarë të NATO-s).

15. "I varur", (përveç personave të përkufizuar në protokoll, neni 3, paragrafi 1 (c); Marrëveshje, neni I, paragrafi 1 (c); dhe ata persona të cilëve u jepet i njëjti status nga PfP SOFA) përfshin çdo person të njohur nga shteti dërgues ose nga një shtab aleat si i varur i një anëtari siç përkufizohet në paragrafin 13 më sipër, sipas rastit.

16. "Aktivitete shtesë" për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje Shtesë janë subjektet e varura, dhe detashmentet e NATO-s dhe jo NATO-s, duke përfshirë shtabet ose njësitë e përkohshme, njësite kombëtare ose ndërkombëtare të mbështetjes dhe përfaqësuesit kombëtarë ushtarakë dhe punonjësit ndërlidhës, agjencitë civile të NATO-s së bashku me ekipet dhe punonjësit e ndërlidhjes.

Neni 2

Dispozita të përgjithshme

1. Republika e Shqipërisë lehtëson zbatimin e Marrëveshjes, protokollit, PfP SOFA dhe kësaj Marrëveshjeje Shtesë, duke përfshirë edhe miratimin dhe zbatimin e legjislacionit të nevojshëm dhe përpiqet të bashkëpunojë me një shtab të aleat në mënyrën më efikase për të zbatuar me efektivitet marrëveshjet e sipërpërmendura.

2. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje Shtesë është lehtësimi i operimit të shtabeve aleate dhe ruajtja e integritetit dhe pavarësisë së këtyre Shtabeve dhe anëtarëve të tyre. Të drejtat që u jepen individëve jepen nga Republika e Shqipërisë në interes të NATO-s dhe në mbështetje të një shtabi aleat dhe jo për përfitimin personal të këtyre individëve. Shtabet supreme dhe shtabet aleate mbeten kujdestarët e të drejtave.

3. Kjo Marrëveshje Shtesë synon të sigurojë përputhshmëri me vendimet e miratuara nga Këshilli i Atlantikut Verior, si dhe rregulloret dhe politikat e NATO-s. Në pajtim me këtë, kuptohet që aktivitetet zyrtare përbëjnë si ato që zhvillohen në zbatim të misionit dhe detyrave të atij shtabi aleat, edhe ato aktivitete që zhvillohen me rezervat e fondeve të paalokuara të shtabeve aleate.

4. Pavarësisht nga natyra e aktiviteteve, kuptohet që Republika e Shqipërisë nuk përfiton të ardhura nga aktivitetet ose prona e shtabeve aleate.

5. Një shtab aleat lejohet të ketë flamurin e tij dhe ta shpalosë këtë flamur së bashku me flamurët e NATO-s, shtetet e NATO-s dhe partnerëve, shtetet që marrin pjesë në programet e partneritetit dhe

bashkëpunimit të NATO-s dhe flamurët e çdo organizate tjetër, në pajtim me rregulloret në fuqi për atë shtab. Gjithashtu, një shtab aleat, në pajtim vetëm me rregulloret e NATO-s, mund të projektojë stemën dhe vulën e vet zyrtare. Këto shenja/simbole të shtabit mbrohen rregullisht në bazë të ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe vula zyrtare, me kërkesë të shtabit aleat, njihet nga autoritetet përkatëse shqiptare dhe u komunikohet departamenteve dhe agjencive përkatëse qeveritare.

6. Përveç kur këtyre shtabeve u është dhënë financim ndërkombëtar në pajtim me C-M (69)22, procedurat e miratuara në nenin 3, nenin 4, paragrafi 1, paragrafi 2 dhe paragrafi 5, si dhe garancia e parashikuar në nenin 16, paragrafi 1 nuk shtrihen mbi ato shtabe aleate që janë krijuar në bazë të masave bilaterale ose multilaterale ndërmjet shteteve të NATO-s dhe/ose vendeve partnere; financimi, administrimi dhe vendndodhja e këtyre shtabeve aleate mund t'u nënshtrohen marrëveshjeve të veçanta të lidhura nga shtetet që marrin pjesë në këto marrëveshje. Po ashtu, neni 9, paragrafi 1, paragrafi 2 dhe paragrafi 5 zbatohet vetëm për ato shtabe aleate të ngarkuara me një detyrë në kohë paqeje të autorizuar nga Këshilli i Atlantikut Verior.

7. Aktivitetet shtesë të atashuara shtabeve të aleatëve dhe në mbështetje të këtyre shtabeve të aleatëve dhe personeli i tyre, si dhe personat e varur të tyre, pa cenuar statusin e dhënë sipas Marrëveshjes ose zbatimit të marrëveshjeve të tjera të lidhura në pajtim me Marrëveshjen ose ndryshe, gëzojnë të njëjtin status si ai i dhënë shtabeve të aleatëve dhe anëtarëve të tyre, si dhe personave të varur në këtë Marrëveshje Shtesë, nenet 5, 6, 10, 12 dhe neni 14 deri 32, pa cenuar statusin e shtabeve të aleatëve.

Neni 3

Vendndodhja dhe ndryshimi i vendndodhjes së përhershme të një shtabi aleat

1. Vendndodhja në kohë paqeje e shtabit aleat në territorin e Republikës së Shqipërisë përcaktohet nëpërmjet marrëveshjeve ndërmjet shtabit përkatës suprem dhe Republikës së Shqipërisë. Çdo ndryshim i vendndodhjes së përhershme të Shtabit Aleat në Republikën e Shqipërisë në kohë paqeje do të jetë subjekt i bisedimeve ndërmjet autoriteteve përkatëse shqiptare dhe shtabit suprem përkatës.

2. Republika e Shqipërisë zhdëmton shtabet aleate për kostot që i paguhen personelit civil të përcaktuar në nenin 13, paragrafët 1 dhe 2 të kësaj Marrëveshjeje Shtesë, për të cilat ky personel ka të drejtë në bazë të rregulloreve të zbatueshme të NATO-s dhe legjislacionit shqiptar, përkatësisht, për shkak të humbjes së punës ose transferimit si rezultat i vendimeve të njëanshme nga Republika e Shqipërisë që shkakton mbylljen, pakësimin ose transferimin e shtabeve aleate të ngritura në pajtim me këtë Marrëveshje Shtesë.

3. Asgjë në këtë nen nuk interpretohet sikur pengon ose i kërkon autoritetit përkatës brenda NATO-s të vendosë për mbulimin me fonde të shpenzimeve për zhvendosjen e shtabeve aleate dhe çdo shpenzim të drejtpërdrejtë që lidhet me të.

Neni 4

Instalimet

1. Në pajtim me Marrëveshjen, neni IX (3) dhe protokollin, neni 4, dhe duke vepruar me kërkesë të Shtabit Suprem, Republika e Shqipërisë merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar të gjithë truallin, ndërtesat dhe instalimet fikse që kërkohen për përdorim nga një shtab aleat. Republika e Shqipërisë ofron asetet për të cilat është rënë dakord për një shtab aleat falas dhe pa tarifë, taksë ose licencë, siç parashikohet në nenin 17 më poshtë. Hollësitë përcaktohen në një marrëveshje të veçantë specifike për shtabin përkatës aleat.

2. Pavarësisht sa më sipër, një shtab aleat ka të drejtën të kontraktojë në mënyrë të pavarur për truallin, ndërtesat, instalimet dhe shërbimet, duke iu nënshtruar vetëm aprovimit të autoriteteve përkatëse shqiptare për vendin dhe me kushte jo më pak të favorshme se ato që gëzohen nga Forcat

e Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Me kërkesë të një shtabi aleat, Republika e Shqipërisë jep atë asistencë që mund të jetë e nevojshme për ushtrimin e kësaj të drejte.

3. Në lidhje me përdorimin e truallit, ndërtesave dhe instalimeve, Ministria e Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë mban përgjegjësi për pasjen e autorizimeve që kërkohen nga ligji shqiptar, dhe në këtë rast shtabi aleat ndihmon në marrjen e autorizimeve duke dhënë, me kërkesë, brenda një kohe të shpejtë të gjithë informacionin, dokumentacionin dhe studimet teknike të duhura. Shtabit aleat nuk i kërkohet tarifë për këto autorizime.

4. Pa njoftim ose leje të tjera, një shtab aleat, drejtpërdrejt ose nëpërmjet një koncesionari, mund të verë në funksionim mensa, gjellëtore dhe kafene, dhe po ashtu autorizohet të japë, brenda ambienteve të tij (këtu përfshihen kampet, pajisjet dhe këndet), koncesione në lidhje me ngritjen e këtyre funksioneve të shërbimit dhe pa u kufizuar në berberana dhe sallone bukurie, lavanderi dhe pastrime kimike, shërbime bankare dhe të udhëtimit. Nga ana tjetër, koncesionarët përmbushin legjislacionin shqiptar për licencat dhe lejet.

5. Asetet që kërkohen nga fondet ndërkombëtare dhe asetet (përfshirë truallin, ndërtesat dhe instalimet fikse) që ofrohen falas nga Shqipëria për përdorim nga një shtab aleat (përveç tarifës nominale), nëse nuk kërkohen më nga shtabi aleat, i nënshtrohen procedurës së parashikuar në protokoll, neni 9.

Neni 5

Paprekshmëria e ambienteve

1. Ambientet e një shtabi aleat janë të paprekshme. Çdo hyrje në këto ambiente nga zyrtarët shqiptarë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare do të kërkojë aprovimin e kreut të shtabit aleat ose të përfaqësuesit të caktuar.

2. Hyrja në ambientet e shtabit aleat të zëna nga njësitë e varura, agjencitë e NATO-s, njësitë kombëtare të ndryshme nga njësitë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë ose nga organizatat ndërkombëtare, qeveritare dhe joqeveritare, dhe organet ndërkombëtare që gjenden në ambientet e shtabit aleat, mbulohen gjithashtu nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje Shtesë. Kushtet e tjera përveç hyrjes mund t'u nënshtrohen marrëveshjeve të mëtejshme bilaterale me Shqipërinë.

3. Me kërkesë dhe sipas vendimit të marrë nga kreu i shtabit aleat, autoritetet shqiptare të inspektimit të punës mund të lejohen të hyjnë në zonat e shtabit aleat për qëllime inspektimi dhe në orare të arsyeshme, kur personat e punësuar në pajtim me nenin 13, paragrafi 2 të kësaj Marrëveshjeje Shtesë (personeli me normën e pagës lokale) përmbushin aktivitetet e tyre.

4. Asgjë në këtë nen nuk interpretohet për të realizuar paprekshmërinë e arkivave dhe dokumenteve të tjera zyrtare të një shtabi aleat ose të procedurës së verifikimit të parashikuar nga protokolli, neni 13. Kjo nuk përbën as të drejtë për inspektimet e punës së institucioneve shqiptare për të përmbushur funksionet në lidhje me detyrat ose punësimin ndërkombëtar të civilëve ndërkombëtarë të NATO-s, ose në lidhje me personelin e angazhuar ndryshe nga shtabi aleat për aktivitetet e tij, në pajtim me nenin 32, paragrafi 1 i kësaj Marrëveshjeje Shtesë. Shtabi aleat i asiston këto autoritete në përmbushje të detyrave të tyre. Inspektimet e ambienteve të përcaktuara në këtë nen kryhen vetëm me aprovimin e kreut të shtabit aleat dhe në pajtim me marrëveshjet e zbatueshme të sigurisë dhe rregulloret e sigurisë të NATO-s.

Neni 6

Imuniteti i shtabit aleat

Imuniteti nga konfiskimi, sekuestrimi ose masa të tjera përmbarimore të parashikuara në nenin 11, paragrafi 2 i Protokollit, jepet pa dallim për çdo infrastrukturë, artikull ose fonde në pronësi ose zotërim

të Shtabit Aleat ose të cilitdo që vepron në emër të shtabit aleat. Kjo dispozitë nuk shtrihet mbi njësitë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë të caktuara te një shtab aleat në territorin shqiptar, nëse prona, subjekt i zbatimit, është në pronësi të Republikës së Shqipërisë, përveç kur detyrimi drejtohet ndaj shtabit aleat.

Neni 7

Imuniteti dhe privilegjet e personelit të nivelit të lartë

1. Imunitetet dhe privilegjet e mëposhtme u jepen Oficerëve të Përgjithshëm dhe të Flamurit (grada OF-6 dhe më lart e NATO-s) dhe titullarëve të gradave të barasvlershme të një shtabi aleat për kohëzgjatjen e misionit të tyre, me kusht që këta persona të shërbejnë në një post ndërkombëtar:

a) Imunitet nga të gjitha veprimet ligjore të institucioneve shqiptare, arrestimi ose ndalimi;

b) Paprekshmëri e letrave dhe dokumenteve të tyre personale;

c) Lehtësi në lidhje me monedhën ose këmbimin, siç u jepet personelit të huaj diplomatik me status të barasvlershëm;

d) Imunitete dhe lehtësi në Republikën e Shqipërisë në lidhje me bagazhin personal që i jepet personelit të huaj diplomatik me status të barasvlershëm; dhe

e) Imunitet nga juridiksioni shqiptar në lidhje me fjalët e thëna dhe veprimet e kryera, duke përfshirë fjalët e shkruara prej tyre, kur ata janë në cilësi zyrtare dhe kur veprojnë brenda kuadrit të autoritetit të tyre.

2. Për qëllimet e këtij neni, "post ndër-kombëtar" nënkupton një post të identifikuar si të tillë në një vendim të Këshillit të Atlantikut Verior ose në një marrëveshje apo masë ndërkombëtare.

3. Në pajtim me kushtet e përcaktuara në këtë nen, dhe nëse kreu i shtabit aleat ka një gradë poshtë gradës OF-6 të NATO-s ose një gradë të barasvlershme civile, imunitetet e përcaktuara më sipër shtrihen mbi kreun dhe zëvendësin. Funksioneve të tjera për personelin poshtë gradës OF-6 të NATO-s dhe gradës së barasvlershme civile u jepet statusi i përcaktuar në këtë nen, me kërkesën e Shtabit Suprem.

4. Nëse personat e përmendur në këtë nen janë shtetas shqiptarë, atyre u jepen vetëm imunitetet dhe privilegjet e parashikuara në nënparagrafët (b) dhe (e) të paragrafit 1 të mësipërm.

5. Imunitetet e parashikuara në këtë nen ruhen pasi mbaron emërimi, në lidhje me periudhën e misionit të tyre.

6. Në Republikën e Shqipërisë dhe gjatë cilësisë së tyre zyrtare, imunitetet e parashikuara në këtë nen zbatohen njëlloj për Oficerët e Përgjithshëm dhe të Flamurit (grada OF-6 dhe më sipër të NATO-s) dhe titullarët civilë dhe gradat e barasvlershme të çdo shtabi të aleatëve që gjenden jashtë Shqipërisë.

7. Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë vendos dhe mban një listë të përditësuar të personave që përfitojnë nga të gjitha ose një pjesë e imuniteteve dhe privilegjeve të parashikuara në paragrafët 1-5 më lart. Një shtab aleat bashkëpunon me autoritetet shqiptare për të lehtësuar respektimin e legjislacionit shqiptar dhe për të parandaluar abuzimin me imunitetet dhe privilegjet e dhëna, ku kuptohet që statusi jepet jo për përfitim personal të atyre që e marrin atë, por me qëllim që t'u jepet mundësi të përmbushin funksionet e tyre në mbështetje të Traktatit të Atlantikut Verior. Imunitetet mund të tërhiqen nga SACEUR-i ose SACT-i, sipas rastit, me kërkesë të Republikës së Shqipërisë, kurdoherë që imuniteti do të pengonte zhvillimin normal të procesit gjyqësor dhe me kusht që heqja dorë të mos ndikonte negativisht në interesat e komandave të tyre.

Neni 8

Statusi i anëtarëve të personelit të caktuar nga organizata të tjera

Përveç kur personeli i caktuar nga organizatat ndërkombëtare, qeveritare dhe joqeveritare, ose

organet ndërkombëtare tashmë gëzojnë statusin sipas marrëveshjeve ose masave të veçanta ku Republika e Shqipërisë është Palë, statusi i dhënë anëtarëve dhe personave në ngarkim të tyre sipas kësaj Marrëveshjeje Shtesë, me njoftimin e një shtabi aleat drejtuar Republikës së Shqipërisë, u jepet këtyre anëtarëve të personelit të caktuar, ose, që veprojnë në mbështetje të shtabit aleat dhe personave në ngarkim të tyre.

Neni 9

Forca e personelit të shtabit aleat

1. Në kohë paqeje, shtabi përkatës suprem autorizohet të rrisë forcën e personelit të çdo shtabi aleat në çdo vit me 10% më shumë, pa aprovimin paraprak të Republikës së Shqipërisë dhe mund ta rrisë më tej, duke njoftuar Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë për çdo rritje të tillë. E gjithë rritja nuk kalon 30% të numrit të personelit që shtabi i aleatëve ka në ditën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje Shtesë pa pëlqimin paraprak të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Kjo dispozitë nuk zbatohet në rast se një rritje sigurohet nëpërmjet vendimeve të miratuara nga Këshilli i Atlantikut Verior.
2. Gjatë përgatitjeve dhe zhvillimit të stërvitjeve dhe operacioneve të drejtuara nga NATO-ja, shtabi aleat autorizohet të rrisë fuqinë e personelit me më shumë se 10% mbi nivelin ekzistues në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje Shtesë (ose rritje efektive të aprovuar sipas paragrafit 1 më sipër). Në këtë rast, shtabi i aleatëve informon Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë për këtë rritje.
3. Një shtab aleat informon çdo vit Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë për fuqinë faktike të Shtabit dhe, si lehtësi për imunitetet dhe të drejtat, jep informacionin e përshtatshëm për caktimin e anëtarëve dhe personave në ngarkim të tyre, duke përfshirë zgjatjen e prezencës në Republikën e Shqipërisë të personave në ngarkim të tyre, në pajtim me nenin 32 të kësaj Marrëveshjeje Shtesë. Procedura e hollësishme përcaktohet nga shtabi aleat dhe autoritetet e caktuara shqiptare.
4. Nëse trajnime ose stërvitje të çdo lloji duhet të zhvillohen nga një shtab aleat ose nga formacione nën drejtimin e këtij shtabi, autoritetet shqiptare mund t'i kërkojnë shtabit aleat të bëjë njoftim paraprak dhe të marrë aprovimin për këto aktivitete.
5. Aktivitetet shtesë (siç përkufizohen në nenin 1, paragrafi 15 të kësaj Marrëveshjeje Shtesë), përveç atyre që themelohen ose deklarohen se themelohen në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje Shtesë, nuk caktohen pa aprovimin paraprak të Këshillit të Atlantikut Verior ose të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, sipas rastit.

Neni 10

Hyrja, largimi, puna dhe qëndrimi

1. Përveç përjashtimeve të parashikuara nga Marrëveshja, neni III, paragrafi 1, dhe protokolli, neni 4, por pa cenuar të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në Marrëveshje, neni III, paragrafët 4 dhe 5, dhe në protokoll, neni 4, (b) dhe (c), anëtarët joshqiptarë dhe personat në ngarkim të tyre përjashtohen nga kërkesat për vizë shqiptare dhe kërkesat e emigrimit, detyrimet e shoqëruara me qëndrimin dhe regjistrimin, si dhe dispozitat në lidhje me lejet e punës sipas ligjit shqiptar.
2. Republika e Shqipërisë lejon ushtrimin e të gjithë profesioneve që ushtrohen nga anëtarët vetëm në lidhje me aktivitetet e shtabit aleat, pa kërkuar asnjë lloj tarife, licence apo kredenciale dhe/ose tatim kombëtar ose lokal, qoftë në administratën qendrore ose lokale. Republika e Shqipërisë njeh gjithashtu ato autorizime që mbahen nga personat në ngarkim, nëse ata përfshihen në aktivitete zyrtare të një shtabi aleat.
3. Republika e Shqipërisë do të përfshijë çdo shtab aleat, që ndodhet në territorin e saj në

regjistrin e organizatave ndërkombëtare me përfaqësi në Republikën e Shqipërisë dhe pa cenuar Marrëveshjen, nenin III, dhe protokollin, neni 5, u lëshon të gjithë anëtarëve joshqiptarë të shtabit aleat dhe personave në ngarkim të tyre të njëjtat karta identiteti që lëshohen për organizatat ndërkombëtare me përfaqësi në Republikën e Shqipërisë, ku njihet plotësisht që kjo procedurë nuk jep asnjë status apo të drejta të tjera.

4. Anëtarët, të cilët nuk janë qytetarë shqiptarë ose me banim të zakonshëm në Republikën e Shqipërisë, së bashku me personat në ngarkim të tyre, ndodhen në Republikën e Shqipërisë në mbështetje të një shtabi aleat dhe prania e tyre është ekskluzivisht e lidhur me shtabin aleat. Po ashtu, prania e tyre është e një natyre të përkohshme jorezidente, pavarësisht kohëzgjatjes së porosive ose kontratës. Rrjedhimisht, termat rezident i zakonshëm dhe vendqëndrim i zakonshëm nuk zbatohen ose aplikohen në çdo drejtim nga Republika e Shqipërisë për këta anëtarë të shtabit aleat ose personat në ngarkim të tyre, të pranishëm në Shqipëri.

Neni 11

Cilësia ligjore e shtabit suprem

1. Shtabi Suprem ka personalitet juridik në pajtim me nenet 10 dhe 11 të protokollit dhe kanë cilësinë, veçanërisht, të lidhin kontrata dhe të sigurojnë, të kenë në pronësi dhe disponojnë pasuri, pa iu nënshtruar ndonjë mase të mëtejshme në Republikën e Shqipërisë.

2. Republika e Shqipërisë njeh që një shtab aleat mund të përfaqësojë ose ushtrojë cilësinë, veçanërisht, të lidhë kontrata dhe të sigurojë, të ketë në pronësi dhe disponojë pasuri në emër të Shtabit Suprem, nëse autorizohet rregullisht për ta bërë këtë.

3. Në pajtim me një marrëveshje të veçantë ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe një shtabi aleat, Republika e Shqipërisë, nëpërmjet strukturave ligjore që përfaqësojnë shtetin në gjykata, vepron në emër të këtij shtabi në çështjet ligjore, në të cilat shtabi aleat është palë e interesuar. Shtabi aleat rimburson Republikën e Shqipërisë vetëm për shpenzimet e bëra nga autoritetet shqiptare, për të cilat është rënë paraprakisht dakord me shtabin aleat.

4. Kuptohet që një shtab aleat që themelohet nëpërmjet masave bilaterale dhe multilaterale ndërmjet shteteve të NATO-s dhe/ose shteteve partnere, mund të ushtrojë cilësinë e tij për të vepruar në emër të saj sipas përcaktimit nga ligji shqiptar dhe kuadri në të cilin është themeluar dhe kontrollohet, pa ndikuar në statusin, të drejtat dhe detyrimet e shtabit suprem ose NATO-s.

Neni 12

Pretendimet

1. Në pajtim me kufizimet e parashikuara në Marrëveshje, neni XV, protokoll, neni 16, dhe duke marrë rregullisht parasysh nenin 11, paragrafi 4 i mësipërm, pretendimet për dëmin ose dëmtimin e personave ose pasurisë në Republikën e Shqipërisë, që rrjedhin nga aktivitetet e një shtabi aleat ose operacionet ose stërvitjet e tjera të NATO-s në territorin shqiptar dhe të bashkërenduara me autoritetet përkatëse shqiptare, gjykohen dhe zgjidhen në pajtim me Marrëveshjen, neni VIII, dhe me protokollin, neni 6, sipas rastit.

2. Shtabet supreme kanë të drejtën të vetë-sigurohen ndaj detyrimeve dhe në këtë mënyrë përjashtohen nga çdo kërkesë për sigurim të detyrueshëm sipas ligjeve shqiptare.

3. Me kërkesë të një shtabi aleat, pretendimet që rrjedhin nga kontratat trajtohen dhe gjykohen nga Republika e Shqipërisë nëpërmjet procesit që rregullon kontratat publike, me kusht që këto kontrata të zbatojnë ligjet shqiptare.

4. Republika e Shqipërisë cakton pikat e nevojshme të kontaktit në administratën e saj për zgjidhjen e pretendimeve.

Neni 13

Personeli civil i punësuar nga shtabi aleat

1. Një shtab aleat mund të realizojë masa të drejtpërdrejta për punësimin e punonjësve civilë ndërkombëtarë të NATO-s:

a) Termat dhe kushtet e këtij punësimi rregullohen ekskluzivisht nga rregulloret e zbatueshme të NATO-s dhe kontratat e punësimit. Mosmarrëveshjet që i përkasin këtij punësimi trajtohen vetëm në pajtim me rregulloret e zbatueshme të aprovuara nga Këshilli i Atlantikut Verior. Nuk lejohet drejtimi te gjykatat, organet, agjencitë ose forume të ngjashme në Shqipëri, dhe në rast kur punonjësit civilë ndërkombëtarë të NATO-s do të pranonin të përdornin organet administrative ose gjyqësore kombëtare për të ndjekur një mosmarrëveshje punësimi, autoritetet shqiptare njoftojnë organet përkatëse administrative ose gjyqësore për mungesën e juridiksionit të tyre.

b) Në pajtim me nenin 7, paragrafi 2 i protokollit, punonjësit civilë ndërkombëtarë të NATO-s përjashtohen nga të gjitha tatimet, si dhe kontributet për skemat sociale dhe të pensioneve të Republikës së Shqipërisë, mbi pagat dhe shpërblimet e paguara atyre në cilësinë si punonjës civilë ndërkombëtarë të NATO-s.

2. Sipas parashikimit në Marrëveshje, neni IX, paragrafi 4, një Shtab Aleat mund të punësojë punonjës lokalë civilë (personel me normë page lokale) në të njëjtat kushte si çdo punëdhënës sipas ligjeve shqiptare.

a) Sistemet e administrimit dhe klasifikimit të pozicioneve caktohen nga rregulloret e NATO-s ose, nëse përfshihen njësitë e mbështetjes, rregulloret e shtetit dërgues, sipas masave bilaterale ose multilaterale në fuqi.

b) Mosmarrëveshjet e punës ndërmjet një Shtabi dhe personelit me normë page lokale gjykohen në pajtim me rregulloret përkatëse të NATO-s, megjithatë, pa cenuar të drejtën e këtij personeli për mbrojtjen juridiksionale të dhënë nga ligji shqiptar.

c) Shtabi Aleat përmbush detyrimet sipas ligjit shqiptar për të bërë zbritjet e kërkuara (dhe kontributet e sigurimeve sociale) mbi pagat dhe shpërblimet e paguara personelit të normës së pagës lokale. Agjencitë shqiptare marrin masat e nevojshme me shtabin aleat për vjeljen e kontributeve financiare të përmendura më sipër. Njësitë kombëtare të mbështetjes, organizatat ndërkombëtare, shumëkombëshe, qeveritare, joqeveritare dhe organet ndërkombëtare janë përgjegjëse për masat e tyre në lidhje me personelin me normë page lokale në Republikën e Shqipërisë.

3. Personeli civil i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni dhe me shtetësi shqiptare mund të detyrohen të përmbushin detyrimet e shërbimit ushtarak shqiptar. Republika e Shqipërisë bën përjashtime nga shërbimi ushtarak shqiptar dhe trajnimi rezervist, mobilizimi, kushtrimi, detyrat e mbrojtjes civile dhe shërbime të ngjashme, nëse kjo kërkohet nga një shtab aleat.

Neni 14

Kontraktorët; ekspertët teknikë, specialistët dhe konsulentët

1. Një shtab aleat, në mënyrë të pavarur dhe në pajtim me rregulloret e NATO-s, mund të përftojë mallra dhe shërbime nëpërmjet kontratave sipas të drejtës së detyrimeve (kontrata tregtare), individualisht ose sipas një kontrate të lidhur me një shoqëri, firmë, agjent, që përfshin shërbime të specializuara nga ekspertë teknikë, specialistë dhe konsulentë.

2. Kontraktorët, që nënkupton shoqëritë dhe firmat, përjashtohen nga ligjet dhe rregulloret e Republikës së Shqipërisë në lidhje me kushtet e licencimit dhe regjistrimit të biznesit, me kusht që ato të jenë:

a) shoqëri dhe firma joshqiptare; dhe

b) jorezidente në Republikën e Shqipërisë; dhe

c) japin ekspertizë teknike ose përmbushin funksione specialiteti dhe konsultative; dhe

d) ekskluzivisht në Republikën e Shqipërisë për të zbatuar një kontratë me ose në mbështetje të

Shtabit Aleat.

Termat dhe kushtet e punësimit të punonjësve, detyrimet për të raportuar dhe mbajtur tatimet dhe kontributet shoqërore, me përjashtimet e përcaktuara më poshtë, përcaktohen në pajtim me ligjin shqiptar dhe marrëveshjet ndërkombëtare, sipas rastit.

3. Të punësuarve të kontraktorit, që konsi-derohen si ekspertë, specialistë dhe konsulentë teknikë të punësuar nga një kontraktor sipas përcaktimit në paragrafin 2 më lart ose sipas një kontrate me një shtab aleat sipas parashikimit të paragrafit 1, e pranishme në Republikën e Shqipërisë vetëm për qëllimin e ekzekutimit të një kontrate ose në mbështetje të një shtabi aleat në Republikën e Shqipërisë, dhe duke përjashtuar shtetasit shqiptarë dhe personat me vendqëndrim të zakonshëm në Republikën e Shqipërisë gjatë kohëzgjatjes së kontratës së tyre dhe sipas të njëjtave kufizime të anëtarëve të emëruar, u jepet statusi i mëposhtëm nga Republika e Shqipërisë:

a) Përjashtim nga kërkesat për vizë, vendqëndrim dhe regjistrim, sipas parashikimit në këtë Marrëveshje Shtesë, neni 10, paragrafi 1. Kjo shtrihet, gjithashtu, edhe për personat në ngarkim të tyre.

b) Përjashtim nga kërkesat për leje pune.

c) Përjashtim nga importi për sendet e ekonomisë së tyre shtëpiake, në përputhje me nenin 17 të kësaj Marrëveshjeje Shtesë.

d) Njohje e lejes së drejtimit të mjetit të parashikuar në këtë Marrëveshje Shtesë, neni 27. Kjo shtrihet edhe te personat në ngarkim të tyre.

e) Leje për të mbështetur dhe marrë pjesë në aktivitetet e moralit dhe mirëqenies së shtabit aleat. Kjo shtrihet edhe te personat në ngarkim të tyre.

f) Akses në shërbimet arsimore në pajtim me nenin 31 dhe mirëqenien e personave në ngarkim të tyre, në pajtim me nenin 32.

4. Të punësuarit e kontraktorit nuk përjashtohen nga tatimet mbi të ardhurat e fituara nga punësimi në një shtab aleat në bazë të kësaj Marrëveshjeje Shtesë. Po ashtu, tatimi i këtyre të ardhurave përcaktohet nga marrëveshjet e zbatueshme ndërkombëtare dhe ligji shqiptar.

5. Në pajtim me nenin 4, autoritete shqiptare përcaktojnë nëse të punësuarit e kontraktorëve dhe personat në ngarkim të tyre konsiderohen persona me qëndrim ose rezidentë të zakonshëm të Republikës së Shqipërisë.

6. Një shtab aleat informon Republikën e Shqipërisë për kontraktorët dhe të punësuarit e kontraktorëve, që gëzojnë statusin e përcaktuar më sipër dhe për prishjen e kontratave me kontraktorët, tërheqjen e të punësuarve të kontraktorëve dhe për statusin e dhënë nga shtabi aleat.

Neni 15

Certifikimi i sigurisë

I gjithë personeli civil i përmendur në nenin 13 të kësaj Marrëveshjeje Shtesë, si dhe punonjësit kontraktorë, ekspertët, specialistët dhe konsulentët teknikë të përmendur në nenin 14 të kësaj Marrëveshjeje Shtesë, pavarësisht nga shtetësia e tyre, kanë një certifikatë sigurie në pajtim me rregulloret dhe politikat e NATO-s. Certifikata e sigurisë për shtetasit shqiptarë jepet nga autoritetet shqiptare nëse kërkohet nga një shtab i aleatëve.

Neni 16

Çështjet bankare dhe monedha

1. Në pajtim me Marrëveshjen, neni XIV dhe protokollin, neni 12, një shtab aleat mund të hapë dhe të mbajë llogari bankare dhe adresa postare dhe të mbajë dhe operojë llogari në monedhat e çdo lloji. Këto llogari përjashtohen nga legjislacioni shqiptar për monedhat në Republikën e Shqipërisë dhe nga çdo masë emergjence kombëtare, ligjet ose legjislacioni për llogaritë bankare ose adresat postare, dhe llogaritë e mbajtura nga shtabi aleat të cilëve u jepen financim ndërkombëtar në

përputhje me C-M (69) 22 garantohen nga Republika e Shqipërisë në tërësinë e tyre. Po ashtu, një shtab aleat mund të mbajë para dhe monedha të ta gjitha llojeve dhe pa asnjë kufizim për këmbimet. Një shtab aleat, të cilit i jepet financim ndërkombëtar në pajtim me C-M (69)22, dhe çdo llogari e mbajtur prej tij, për më tepër i nënshtrohet procedurave të përcaktuara në rregulloret financiare të NATO-s, menaxhimit dhe kontrollit të kontrolluesit përkatës financiar dhe auditimet e kryera nga auditi i emëruar për shtabin aleat dhe Bordi Ndërkombëtar i Auditëve të NATO-s.

2. Nuk ka kufizim për mundësinë e anëtarëve dhe personave në ngarkim të tyre për të hapur dhe mbajtur llogari bankare dhe adresa postare në Republikën e Shqipërisë. Ndërsa llogaritë personale bankare dhe adresat postare të anëtarëve dhe të personave në ngarkim të tyre, normalisht, u nënshtrohen rregulloreve përkatëse që rregullojnë këto llogari, megjithatë anëtarëve, të cilët nuk janë shtetas shqiptarë ose rezidentë të zakonshëm në Republikën e Shqipërisë, dhe personave në ngarkim të tyre u lejohen transferta pa kufizim për fondet për në dhe nga llogaritë e tyre në Republikën e Shqipërisë. Republika e Shqipërisë mund të kërkojë informacion për shumat dhe llogaritë që duhet të certifikohen nga shteti dërgues.

Neni 17

Imunitetet dhe të drejtat fiskale

1. Republika e Shqipërisë nuk përfton të ardhura nga aktivitetet ose prona e shtabit aleat. Në pajtim me Protokollin, neni 8, dhe me Marrëveshjen, neni XI, shtabi aleat gëzon përjashtim në Republikën e Shqipërisë nga të gjitha tatimet, detyrimet dhe tarifat. Përjashtimet detajohen në këtë nen dhe mund t'i nënshtrohen zbatimit të mëtejshëm të hollësishëm nëpërmjet masave reciproke. Përjashtimi nuk shtrihet mbi njësinë kombëtare shqiptare të mbështetjes përveç nga sa parashikohet në këtë nen dhe nëse vepron në emër të ose si pjesë e një shtabi aleat.

2. Një shtab aleat përjashtohet nga tatimet, detyrimet dhe tarifat në lidhje me licencat ose lejet, pavarësisht nga niveli në të cilin ato mund të vendosen mbi të gjitha aktivitetet e saj zyrtare, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

a) Importimin dhe rieksportimin nga Republika e Shqipërisë të çdo malli që përdoret për aktivitetet zyrtare të shtabit aleat, si dhe çdo pasurie tjetër ose shërbimi , të përftuar sipas një kontrate tregtare të lidhur jashtë Republikës së Shqipërisë;

b) Përftimi i mallrave, pasurisë tjetër, si dhe shërbimet në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë restaurimin dhe ndërtimin e godinave brenda dhe jashtë një shtabi aleat në mbështetje të funksioneve të saj;

c) Eksportimi nga Republika e Shqipërisë nga shtabi aleat i mallrave, pasurive të tjera, si dhe shërbimeve, të përftuara në Republikën e Shqipërisë në pajtim me paragrafin "b" të mësipërm;

d) Çdo e ardhur ose fond i alokuar ose i kthyer nëpërmjet aktiviteteve zyrtare të një shtabi aleat, në formën e tarifave, detyrimeve ose dhurimeve, ose interes i gjeneruar nga fondet e mbajtura prej tij;

e) Blerja, pronësia, regjistrimi dhe operimi i automjeteve dhe rimorkiove të tij zyrtare, duke përfshirë përdorimin prej tyre të rrugëve, urave, tuneleve, trageteve dhe infrastrukturës së ngjashme;

f) Përveç shumave që nuk janë gjë tjetër përveç pagesave për shërbimet e dhëna, një shtab aleat përjashtohet nga tatimet, detyrimet, tarifat dhe pagesat në Republikën e Shqipërisë, për:

1. Karburantet dhe lubrifikantët për përdorimin e avionëve, anijeve ose automjeteve të tjera dhe rimorkiove në pronësi ose operuar në mbështetje të aktiviteteve zyrtare të shtabit aleat;

2. Karburantet dhe lubrifikuesit e përdorur për sistemet e ngrohjes/ftohjes ose gjeneratorët e energjisë në operimin e një shtabi aleat;

3. Përdorimin e porteve, aeroporteve dhe pistave për avionët;

4. Biletat e avionëve, trenit dhe tragetit, të blera nga një shtab aleat për udhëtimet zyrtare;

5. Aktivitetet e mbuluara nga legjislacioni dhe programet mjedisore, veçanërisht asgjësimin dhe

disponimin e pasurisë dhe përdorimin e infrastrukturës;

6. Përdorimin ose operimin e radios, televizionit ose mjeteve dhe pajisjeve të tjera të telekomunikimit të prokuruara për qëllime ushtarake, duke përfshirë detyrimet e pullës dhe tarifat e licencave dhe përdorimin e spektrit;

7. Dërgimin dhe marrjen e postës dhe paketave nga jashtë ose brenda territorit të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet shërbimeve të tij postare, me përjashtim të detyrimeve postare të zbatuara në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare;

8. Fondet e transferuara për në ose nga një shtab aleat.

3. Përjashtimet e parashikuara në këtë nen zbatohen gjithashtu për:

a) Importin ose furnizimin e mallrave, pasurive të tjera dhe shërbimet e përftuara nga Republika e Shqipërisë duke vepruar specifikisht për shtabin aleat ose NATO-n;

b) Mallrat, pasuritë e tjera, si dhe shërbimet, e importuara ose të përftuara në Republikën e Shqipërisë nga ose në emër të një shtabi aleat për përdorim nga subjektet tregtare, shërbimet e të cilëve përftohen nga shtabi aleat nëpërmjet një kontrate tregtare të përmbushur brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë;

c) Aktivitetet e programeve të moralit dhe mirëqenies së shtabit aleat në lidhje me mallrat, furnizimet, pasuritë e tjera, si dhe shërbimet, me kusht që këto aktivitete të aprovohen rregullisht nga Shtabi Aleat përgjegjës.

4. Mensat, kafenetë dhe gjellëtoret

a) Përjashtimet tatimore që i jepen shtabit aleat në protokoll, neni 8, dhe më sipër, përfshijnë importin dhe blerjet në Republikën e Shqipërisë të pajisjeve, furnizimeve dhe mallrave dhe shërbimeve të tjera në sasi të arsyeshme për operimin e mensave, gjellëtoreve dhe kafeneve, të ngritura me qëllim shitjen ose shpërndarjen e këtyre pajisjeve, furnizimeve ose shërbimeve për anëtarët ose personat në ngarkim të tyre.

b) Pa cenuar të drejtat e shteteve dërguese për të përcaktuar dhe operuar mekanizma të ngjashëm në pajtim me Marrëveshjen, neni XI, paragrafi 4, shtabi aleat mund të operojë, drejtpërdrejt ose nëpërmjet një koncesionari:

1. Mensat, që kuptohen si dyqane ose këmbime, që lehtësojnë sigurimin dhe rishitjen e mallrave dhe shërbimeve pa tatime dhe pa doganë tek anëtarët e identifikuar në këtë nen dhe personat në ngarkim të tyre, u nënshtrohen kufizimeve të përcaktuara në këtë Marrëveshje Shtesë.

2. Kafenetë, që kuptohen si ambiente ngrënieje që shërbejnë për personat e identifikuar në këtë nen;

3. Gjellëtoret, që kuptohen si ambiente për të shërbyer vakte të lehta, pije dhe nxitjen e shoqërizimit ndërmjet personave të identifikuar në këtë nen.

c) Një shtab aleat përjashtohet nga tatimet mbi të ardhurat që rrjedhin nga shitjet dhe shërbimet e dhëna në mensat, gjellëtoret dhe kafenetë e tyre, ose nga aktivitetet e tjera të moralit dhe mirëqenies, të zhvilluara drejtpërdrejt ose nëpërmjet një koncesionari. Përjashtimi tatimor që gëzohet nga shtabi aleat nuk shtrihet mbi të ardhurat ose fitimin e përftuar nga një koncesionar dhe për të cilat koncesionari mund të jetë përgjegjës në bazë të ligjeve shqiptare për të raportuar për qëllime tatimore.

d) Të gjithë personat e lejuar në ambientet e një shtabi aleat, duke përfshirë personelin me normë page lokale, të gjithë personelin e kontraktuar dhe vizitorët, pavarësisht nga shtetësia e tyre, mund të blejnë ose t'u jepen artikuj ushqimore dhe pije për t'u konsumuar në kafenetë ose gjellëtoret e shtabit dhe mund të blejnë artikuj të etiketuar për stërvitjen /aktivitetin e shtabit aleat për përdorim personal. Kjo nuk përfshin hyrjen në mensat e shtabit aleat.

e) Anëtarëve dhe personave në ngarkim tyre u lejohet hyrja në mensa.

f) Blerja e artikujve në mensa, kafene dhe gjellëtore mund të kufizohet me kufijtë moshorë ose të kufizohet me vendim të shtabit aleat ose nëpërmjet marrëveshjeve me autoritetet shqiptare, siç është

Shtojca e kësaj Marrëveshjeje Shtesë. Artikujt e kufizuar nuk bëhen të disponueshëm nëpërmjet shitjes, këmbimit, dhuratave ose duke iu kaluar ndryshe një personi tjetër.

g) Në bazë të kufizimeve të përcaktuara mbi masën e të drejtave në kuptimin e sasive të lejuara dhe disponimit dhe nëse shtabi aleat nuk ka ngritur mensat, gjellëtoret ose kafenetë e tij në Republikën e Shqipërisë, anëtarët dhe personat në ngarkim të tyre lejohen të përdorin ambientet e shtabit më të afërt të aleatëve ose të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në pajtim me kufizimet e përcaktuara në këtë nen. Po ashtu, anëtarët dhe personat në ngarkim të tyre kanë të drejtën të përdorin ato ambiente të forcave të tyre kombëtare, nëse këto të fundit bien dakord dhe duke iu nënshtruar të njëjtave kushte siç parashikohen në këtë nen.

5. Anëtarët e shtabit aleat, përveç atyre anëtarëve që janë atashuar nga autoritetet shqiptare ose të punësuar nga shtabi aleat dhe që e kanë shtetësinë shqiptare ose që janë me banim të zakonshëm në Republikën e Shqipërisë, janë personat me të drejta, janë anëtarë me të drejta. Anëtarët me të drejta dhe personat në ngarkim të tyre, përveç të drejtave të protokollit, neni 8, paragrafët 2 dhe 3, Marrëveshjes, neni XI, paragrafët 4, 5 dhe 6; dhe në paragrafët e mësipërm, gëzojnë të drejtat e parashikuara më poshtë, që mund t'i nënshtrohen zbatimit të mëtejshëm nëpërmjet masave reciproke:

a) Importi dhe blerja e sendeve personale dhe mobilieve sipas përkufizimit në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje Shtesë.

b) Importi dhe blerja e automjeteve në pronësi private sipas përkufizimit në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje Shtesë. Automjetet mund të zëvendësohen nga importe ose blerje të tjera në Republikën e Shqipërisë, përjashtuar nga taksat dhe tatimet nëse disponohen në pajtim me paragrafin 8 më poshtë.

c) Përjashtimi nga detyrimet e pullës dhe tarifat e licencës për çdo pajisje radiofonike, televizive ose mjet tjetër komunikimi në pronësi personale.

6. Tatimi mbi të ardhurat dhe pasurinë e luajtshme të anëtarëve është sipas parashikimit në Marrëveshje, neni X, paragrafët 1 dhe 2, dhe protokoll, neni 7, dhe përfshin, ndër të tjera, përjashtime për anëtarët me të drejta nga tatimi dhe tarifat e qarkullimit vjetor dhe taksave rrugore në Republikën e Shqipërisë.

7. Përveç së drejtës për të eksportuar dhe rieksportuar dhe pa cenuar protokollin, neni 9, dhe të drejtën e shtabit aleat për të rishitur artikujt në mensa, gjellëtore dhe kafene, shtabi aleat ka të drejtë të disponojë pajisjet, tepricat dhe mbetjet. Duke pranuar se autoritetet shqiptare kanë të drejtën e parablerjes, artikujt mund të disponohen ndryshe:

a) Nëpërmjet shitjes tek individët ose ndërmarrjet tregtare, që janë të autorizuara rregullisht të tregtojnë në Republikën e Shqipërisë, me kusht që të paguhen tatimet dhe detyrimet e Republikës së Shqipërisë bazuar në vlerën e tregut në momentin e disponimit;

b) Pa pagesën e detyrimeve ose tatimeve për shkak të shkatërrimit, vjedhjes ose dëmtimit, me kusht që rrethanat dhe disponimi të certifikohen nga autoritetet shqiptare në një formë të autorizuar për prishjen, dokument doganor apo tjetër të përshtatshëm;

c) Pa pagesën e detyrimeve ose tatimeve, te subjektet, organizata bamirësie dhe të ngjashme, me kusht që ato të jenë të përjashtuara nga tatimet e Republikës së Shqipërisë për artikujt e dhuruar.

8. Me kufizimet e përcaktuara në paragrafin 4/g, më sipër, artikujt e importuar ose blerë pa taksa, tatime, tarifa nga anëtarët dhe personat e varur të tyre, sipas dispozitave të këtij neni, nuk disponohen në Republikën e Shqipërisë me shitje, këmbim ose dhurim, përveç:

a) eksportit ose rieksportit nga personi që gëzon privilegjin;

b) disponimit ndërmjet personave që gëzojnë të njëjtët privilegje;

c) dhuratave të mikpritjes me vlerë të ulët;

d) dhuratave për subjektet, organizata bami-rësie ose të ngjashme, me kusht që ato të jenë të përjashtuara nga tatimet në Republikën e Shqipërisë për artikujt e dhuruar;

e) disponimit me shkatërrim, vjedhje ose dëmtim, me kusht që rrethanat dhe disponimi të

certifikohen nga autoritetet policore shqiptare në një formë të autorizuar për prishjen, dokument doganor apo tjetër të përshtatshëm;

f) nëse detyrimet dhe/ose tatimet në Republikën e Shqipërisë janë paguar bazuar në vlerën e tregut në momentin e disponimit.

9. Të drejtat e shprehura më sipër u jepen shtabeve aleate në mbështetje të misionit të tyre dhe anëtarët dhe personat në ngarkim të tyre nuk përftojnë asnjë të drejtë individuale nga kjo Marrëveshje Shtesë në këtë aspekt. Administrimi i të drejtave i nënshtrohet ligjit shqiptar dhe menaxhimit të shtabit aleat, që:

a) Merr masat e duhura, brenda objektit të autoritetit të tij, për të mbikëqyrur zbatimin e duhur të rregullave dhe legjislacionit mbi lirimin nga tatimet dhe detyrimet dhe për të shmangur abuzimin;

b) Mund t'u kërkojë ndihmë autoriteteve shqiptare për të ndjekur ligjërisht një abuzim;

c) U kërkon të gjithë anëtarëve dhe personave të varur të tyre të nënshkruajnë një deklaratë me mbërritjen e tyre te shtabi aleat, duke njohur kufizimet e parashikuara në këtë nen;

d) Në pajtim me Marrëveshjen, neni XII, paragrafi 1, dhe protokollin, neni 4, mund të lidhë marrëveshje të ndërsjella me Shqipërinë mbi llogaritjen dhe menaxhimin e të drejtave të përshkruara në këtë nen.

10. Për qëllimet e verifikimit të statusit të një shtabi aleat dhe anëtarëve me të drejta dhe personat e tyre të varur sipas kësaj Marrëveshjeje Shtesë në lidhje me formularët e kërkuar për të realizuar blerjet pa tatime dhe detyrime në vendet e BE-së, si dhe importin, eksportin dhe rieksportimin e mallrave, Republika e Shqipërisë cakton një autoritet për të certifikuar formularët e paraqitur nga ose nëpërmjet një shtabi aleat.

11. Përjashtimi jepet për tatimet ose tarifat që mund të zbatohen në Republikën e Shqipërisë pasi kjo Marrëveshje Shtesë të jetë nënshkruar.

12. Dispozitat e këtij neni nuk zëvendësojnë procedurat në lidhje me financimin e projekteve të infrastrukturës së NATO-s dhe zbatimin e paketave të aftësive dhe nuk është synimi për të kufizuar ose zëvendësuar këto të drejta të dhëna një shteti të veçantë ose një organizate ndërkombëtare, qeveritare dhe joqeveritare dhe organeve ndërkombëtare nga autoritetet shqiptare.

13. Asgjë në këtë nen nuk kuptohet sikur kufizon ose cenon ndryshe procedurat dhe të drejtat e dhëna Republikës së Shqipërisë sipas Marrëveshjes, veçanërisht neni IX, paragrafi 2, neni XI, paragrafi 1, dhe neni XII, paragrafi 2.

Neni 18

Mbrojtja e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë

1. Pa cenuar Marrëveshjen, neni II, dhe duke njohur përjashtimet e parashikuara në këtë Marrëveshje Shtesë, ligjet dhe legjislacioni shqiptar në lidhje me mbrojtjen e mjedisit, në të njëjtën mënyrë që ato janë të zbatueshme për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, shërbejnë si standardi minimal për një shtab aleat, si dhe do të zbatohen të gjitha Marrëveshjet dhe udhëzimet përkatëse të NATO-s për Standardizimin.

2. Shtabi Aleat, me ndihmën e autoriteteve shqiptare të parashikuara në paragrafin 6 më poshtë, analizon përputhshmërinë e aktiviteteve të Shtabit Aleat me ligjet dhe legjislacionin shqiptar mjedisor. Këto konsiderata përfshijnë por pa u kufizuar, identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve dhe efekteve potenciale në mjedis, me qëllim që të minimizohen ndikimet e mundshme negative mjedisore dhe, nëse ndikimet negative janë të pashmangshme, të merren masat e përshtatshme korrigjuese. Në këtë aspekt, vëmendje e veçantë u kushtohet aktiviteteve në lidhje me përdorimin dhe ruajtjen e karburanteve, lubrifikantëve dhe municionit, si dhe emetimin e gazrave, nivelet e zhurmës, zonat për trajnim dhe stërvitje dhe asgjësimin e të gjitha llojeve të mbetjeve.

3. Transporti i municioneve, mallrave të rënda dhe materialeve të rrezikshme kryhet në pajtim

me standardet dhe legjislacionin e zbatuar nga Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe merr parasysh marrëveshjet ndërkombëtare në fuqi në Republikën e Shqipërisë, si dhe Marrëveshjet dhe udhëzimet përkatëse të NATO-s për standardizimin.

4. Për punët e ndërtimit dhe inxhinierike të ndërmarra nga një shtab aleat, shtabi përkatës përcakton si nivel minimal standarde mjedisore, ndërtimi dhe inxhinierie (duke përfshirë shëndetin dhe sigurinë) të krahasueshme me standardet, rregullat dhe legjislacionin e zbatueshëm për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Pa cenuar detyrimet në lidhje me punësimin e një fuqie punëtore lokale në pajtim me Marrëveshjen, neni IX, paragrafi 4, një shtab aleat përpiqet të respektojë legjislacionin shqiptar shëndetësor dhe sigurisë në vendin e punës në masën që është e mundur dhe, nëse kjo është ligjërisht, operacionalisht apo ndryshe teknikisht e pamundur, autoritetet shqiptare dhe Shtabi Aleat bien dakord pa vonesë për mjetet e tjera për të arritur mbrojtjen e dëshiruar.

5. Nëse ligji shqiptar ndalon importin e artikujve të caktuar, këto artikuj, me aprovimin e autoriteteve shqiptare, mund të importohen nga një shtab aleat. Një shtab aleat dhe Republika e Shqipërisë bien dakord për kategoritë e artikujve, importi i të cilave aprovohet nga autoritetet shqiptare sipas kësaj dispozite.

6. Autoritetet përkatëse shqiptare japin asistencë për të shqyrtuar përputhshmërinë e aktiviteteve të shtabit aleat me ligjet dhe legjislacionin mjedisor shqiptar, si dhe udhëzimet dhe informacionin mbi legjislacionin, standardet etj, të përmendura më sipër, dhe vë në dijeni një shtab aleat kur standardet shqiptare tejkalojnë ato që vendosen me konventat e zbatueshme ndërkombëtare. Standardet shqiptare të përmendura më sipër i jepen shtabit nga autoritetet përkatëse shqiptare në gjuhët angleze ose frënge.

7. Të gjithë detyrimet, tatimet, tarifat dhe pagesat mjedisore zgjidhen sipas parashikimit të nenit 17 të kësaj Marrëveshjeje Shtesë.

Neni 19

Higjiena publike

1. Një shtab aleat, me mbështetjen e Republikës së Shqipërisë, zbaton legjislacionin shqiptar për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve infektive të njerëzve, kafshëve dhe bimëve dhe për parandalimin dhe kontrollin e dëmtimit të bimëve.

2. Republika e Shqipërisë ofron mjetet dhe asistencën në rastin e situatave emergjente që kanë të bëjnë me sëmundjet infektive lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Një shtab aleat lejon hyrjen në ambientet e tij, në pajtim me nenin 5 të kësaj Marrëveshjeje Shtesë.

3. Një shtab aleat dhe autoritetet shqiptare informojnë menjëherë njëra-tjetrën për përhapjen ose përhapjen e dyshuar, transmetimin dhe eliminimin e çdo sëmundjeje infektive dhe për masat e marra.

4. Nëse një shtab aleat e konsideron të nevojshme të marrë masa për mbrojtjen shëndetësore brenda pajisjeve dhe ambienteve të ofruara për përdorim prej tij, e bashkërendon zbatimin e këtyre mjeteve me autoritetet përkatëse shqiptare.

5. Legjislacioni shqiptar i përmendur më sipër dhe çdo informacion përkatës i jepet një shtabi aleat nga autoritetet përkatëse shqiptare në gjuhën angleze ose frënge.

Neni 20

Evakuimi i anëtarëve dhe personave në ngarkim të tyre

Në pajtim me marrëveshje të veçanta me shtetet dërguese në fjalë, shteteve që kanë atashuar anëtarë në një shtab aleat, në rastin e situatave të emergjencës, u lejohet hyrja në Republikën e

Shqipërisë për qëllimin e evakuimit të personelit të tyre dhe personave në ngarkim të tyre. Republika e Shqipërisë dhe shtabi aleat bashkërendojnë procedurat e përshtatshme për të siguruar evakuimin e menjëhershëm të anëtarëve dhe personave në ngarkim të tyre, që nuk i nënshtrohen evakuimit nga një shtet dërgues.

Neni 21

Korrespondenca dhe komunikimi

1. Për qëllimet e komunikimeve dhe korrespondencës zyrtare, një shtab aleat ka akses të pakufizuar në linjat fikse, celulare si dhe të telefonave satelitorë, shërbimet e internetit, telekomunikimit dhe çdo shërbim tjetër informimi dhe komunikimi, duke përfshirë radion dhe televizionin, shërbimet tokësore dhe satelitore dhe shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë, pavarësisht nëse shërbimi operohet komercialisht apo publikisht.
2. Një shtab aleat ka minimalisht akses për shërbimet e komunikimit ushtarak, korrier dhe postar të Republikës së Shqipërisë në pajtim me marrëveshje të veçanta sipas termave dhe kushteve të krahasueshme me Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
3. Një shtab aleat, në pajtim me politikën e aprovuar me Këshillin e Atlantikut Verior, Marrëveshjen e NATO-s për Standardizimin 2109 dhe marrëveshjet pasuese, mund të vendosin dhe përdorin, me shpenzimet e tyre, sisteme të linjës fikse, celulare si dhe të telefonave satelitorë, shërbimet e internetit, shërbimet postare dhe korrierit dhe çdo shërbim tjetër për sistemin e komunikimit dhe informimit në Republikën e Shqipërisë për përdorim privat dhe zyrtar nga shtabi aleat dhe anëtarët e tij.
4. Një shtab aleat lejohet të vendosë, operojë dhe përdorë rrjete dhe sisteme të klasifikuara dhe të paklasifikuara dhe mjete të komunikimit të sigurt dhe të shifruar në Republikën e Shqipërisë, si dhe të kryejnë monitorimin e atyre sistemeve për arsye sigurie dhe qëllime të tjera të autorizuara.
5. Sipas parashikimit në Marrëveshje, neni XI, paragrafi 3, çdo postë ose komunikim i një shtabi aleat i shënuar ose i deklaruar ndryshe si zyrtar, nuk i nënshtrohet asnjë kufizimi, inspektimi, censure, vonese ose kontrolli tjetër nga autoritetet shqiptare, përveç kur shtabi aleat ka hequr dorë nga imuniteti.
6. Një shtab aleat ka të drejtë të dërgojë dhe marrë korrespondencë dhe paketa zyrtare me korrier ose në qese të vulosura dhe gëzon imunitetin dhe privilegjet e dhëna korrierëve dhe çantave diplomatike.
7. Korrespondenca dhe paketat zyrtare të një shteti dërgues, të përfaqësuar në shtabin aleat, mund të dërgohen nëpërmjet kanaleve kombëtare, nëse këto ofrohen, pa i bërë pagesa Republikës së Shqipërisë ose pa asnjë kufizim, inspektim, censurë, vonesë ose kontroll tjetër.

Neni 22

Telekomunikimi

1. Në pajtim me masat e mëtejshme me autoritetet përkatëse shqiptare në lidhje me vendndodhjet dhe hollësitë teknike të pajisjeve, një shtab aleat mund të importojë, ngrejë, hyjë, operojë dhe mbajë, përkohësisht ose jo përkohësisht, brenda ose jashtë ambienteve të zëna prej saj, ato pajisje të telekomunikimit dhe stacione ushtarake radioje që mund të kërkohen për funksionet e tij operacionale.
2. Republika e Shqipërisë mbetet përgjegjëse dhe ka detyrim të menaxhojë spektrin. Frekuencat që përdoren nga një shtab aleat, së bashku me parametrat e tyre teknikë, vendosen nga shtabi aleat dhe autoritetet shqiptare përgjegjëse për menaxhimin e spektrit, në pajtim me procedurat e caktuara nga autoriteti përkatës i NATO-s. Shtabi aleat dhe Republika e Shqipërisë marrin të gjitha masat e nevojshme për të mënjanuar dhe eliminuar ndërhyrjen e dëmshme te shërbimet e telekomunikimit civil dhe pajisjeve të energjisë elektrike të njëra-tjetrës. Në bazë të koordinimit paraprak me autoritetet përkatëse shqiptare,

një shtab aleat mund të marrë të gjitha masat e nevojshme të sigurisë për të mbrojtur komunikimin e shtabit aleat në Republikën e Shqipërisë për shkak të ruajtjes së sigurisë dhe forcës.

3. Pajisjet e telekomunikimit dhe stacionet ushtarake të radios përdoren ekskluzivisht për qëllime zyrtare, në pajtim me paragrafin e mësipërm.

4. Republika e Shqipërisë përjashton shtabin aleat nga të gjitha çmimet e spektrit të frekuencave.

5. Kërkesat në lidhje me telefonin/telegrafin fiks/sistemet e të dhënave dhe qarqet paraqiten në pajtim me procedurat e caktuara nga autoriteti përkatës i NATO-s.

6. Kriteret, rregulloret dhe normat për punë dhe shërbimet e operatorëve dhe rregullatorëve të telekomunikimit nuk janë më pak të favorshme se ato të zbatuara për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

7. Në vendosjen dhe operimin e pajisjeve të telekomunikimit, shtabi aleat zbaton dispozitat e aprovuara nga Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve dhe çdo rregullore ndërkombëtare ose rajonale e telekomuni-kacioneve, detyruese për Republikën e Shqipërisë, si dhe ligjet dhe legjislacionin shqiptar për telekomunikacionet. Shtabi aleat përjashtohet nga kjo dispozitë në masën që ky përjashtim jepet për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

8. Të gjitha shtabet aleate kanë të drejtë të dërgojnë dhe të marrin mesazhe dhe të dhëna të shifruara.

Neni 23

Policimi brenda dhe jashtë ambienteve

1. Në pajtim me Marrëveshjen, neni VII, paragrafi 10, dhe protokollin, neni 4, paragrafi "b", shtabi aleat ka të drejtën të policojë çdo ambient të zënë prej saj. Personeli i sigurisë i shtabit aleat mund të marrë të gjitha masat e përshtatshme për të siguruar ruajtjen e rendit, disiplinës dhe sigurisë në këto ambiente. Republika e Shqipërisë jep asistencë nëpërmjet policisë ushtarake dhe/ose civile për kreun e shtabit aleat ose të përfaqësuesit të caktuar, nëse kjo kërkohet.

2. Ushtrimi i kompetencave të policisë për ngjarjet jashtë shtabit aleat është përgjegjësi e autoriteteve shqiptare. Jashtë ambienteve të shtabit aleat, personeli i ndërkombëtar i sigurisë i shtabit angazhohet vetëm në rrethanat dhe kushtet e përcaktuara në Marrëveshje.

3. Në pajtim me Marrëveshjen, neni VII, paragrafi 5 (b), dhe protokollin, neni 4, kreu i shtabit aleat ose përfaqësuesi i caktuar njoftohet menjëherë për arrestimin ose ndalimin e anëtarëve ose personave në ngarkim të tyre.

4. Urdhrat gjyqësorë, gjobat dhe fletëthirrjet e lëshuara ndaj anëtarëve të shtabit aleat mund të paraqiten nëpërmjet kreut të shtabit aleat, të cilit i janë atashuar.

Neni 24

Siguria dhe mbrojtja e forcës

1. Në pajtim me politikën e NATO-s për sigurinë dhe politikën e NATO-s për mbrojtjen e forcës, Shqipëria është përgjegjëse për të gjitha aspektet e mbrojtjes së forcës, duke përfshirë vlerësimin e riskut, planifikimin, sigurimin dhe zbatimin, në skenarët e mëposhtëm:

a) mbrojtjen e perimetrit të shtabit aleat;

b) mbrojtjen e takimeve të organizuara nga shtabi aleat por që mbahen jashtë ambienteve të shtabit aleat;

c) mbrojtjen e personave VIP, me vend-ndodhje brenda shtabit aleat ose që e vizitojnë ose ndryshe duke marrë pjesë në aktivitetet e organizuara nga një shtab aleat.

2. Republika e Shqipërisë dhe shtabi aleat marrin masa për:

a) shkëmbimin e informacioneve në lidhje me mbrojtjen dhe sigurinë e forcave;

b) përcaktimin nga shtabi aleat i personave VIP që mund t'i nënshtrohen kërcënimeve.

3. Shtabi aleat nuk zhvillon aktivitete të sigurisë ose mbrojtjes së forcës jashtë ambienteve të shtabit aleat, përveç kur janë vendosur paraprakisht masat me autoritetet përkatëse shqiptare.

Neni 25

Armët

1. Në pajtim me Marrëveshjen, neni VI, shtabi aleat merr masa së bashku me autoritetet përkatëse shqiptare në lidhje me transportimin dhe ruajtjen e armëve dhe municionit. Në pajtim me këto masa, shtabi aleat shpall rregulla të brendshme, në pajtim me legjislacionin e shtetit dërgues dhe të Republikës së Shqipërisë, në lidhje me ruajtjen dhe lëvizjen e armëve dhe municionit ushtarak në ruajtje ose zotërim të tyre, për të siguruar që asnjë nga anëtarët e shtabit aleat nuk merr në zotërim ose mban armë, përveç rasteve kur është i autorizuar.

2. Ligjet shqiptare zbatohen për zotërimin, disponimin dhe transportin e armëve dhe municionit në pronësi private.

Neni 26

Legjislacioni i trafikut dhe automjetet

1. Përveç përjashtimeve të parashikuara në këtë Marrëveshje Shtesë, legjislacioni shqiptar për trafikun zbatohet për operimin e mjeteve motorike dhe rimorkiove zyrtare të Shtabit Aleat dhe për përdorimin e automjeteve, rimorkiove dhe mjeteve lundruese në pronësi private të anëtarëve dhe personave të varur të tyre, pavarësisht nga tipi i tyre.

2. Pa cenuar kërkesat e paraqitura sipas paragrafit 3 të këtij neni, mjeteve motorike dhe rimorkiove zyrtare të shtabit aleat, pavarësisht nga tipi i tyre, u ofrohen të njëjtat përjashtime nga legjislacioni shqiptar për trafikun, që u ofrohen edhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

3. Nëse çmohet e nevojshme nga shtabi aleat dhe duke i kushtuar vëmendjen e duhur sigurisë dhe rendit publik dhe mbrojtjes së mjedisit, Republika e Shqipërisë, në lidhje me automjetet dhe rimorkiot zyrtare të shtabit aleat, jep përjashtimet nga legjislacioni shqiptar në lidhje me specifikimet për ndërtimin, projektimin dhe pajisjet e këtyre mjeteve motorike dhe rimorkiove, pavarësisht nga tipi i tyre.

4. Automjetet e çdo lloji dhe rimorkiot në pronësi private të importuara përkohësisht në pajtim me Marrëveshjen, neni XI, paragrafi 6, dhe protokollin, neni 8, paragrafi 3, gjatë periudhës së këtij importi, u nënshtrohen vetëm legjislacionit minimal për ndërtimin, projektimin dhe pajisjet, i zbatueshëm për automjetet dhe rimorkiot e turistëve në Republikën e Shqipërisë, duke marrë parasysh në të njëjtën kohë si duhet sigurinë dhe rendin publik.

5. Në lidhje me certifikimin e standardeve teknike të automjeteve të përcaktuara më sipër për të gjitha tipat e automjeteve dhe rimorkiove në pronësi private, shtabi aleat mund të përdorë ato që përdoren nga Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë ose, në pajtim me një marrëveshje të veçantë, të ngrejë pikat e veta për inspektimin teknik. Në këtë rast, Republika e Shqipërisë, pa shpenzime nga ana e shtabit aleat jep të gjitha makineritë bazë të nevojshme dhe ofron operatorë, si dhe lëshon certifikatat e nevojshme për inspektimin teknik.

Neni 27

Lejet e drejtimit të mjetit

1. Dispozitat e Marrëveshjes, neni IV, shtrihen mbi të gjithë anëtarët dhe personat në ngarkim të tyre, me kusht që ata të përmbushin kërkesën e lejes së drejtimit në Republikën e Shqipërisë. Nëse kjo kërkohet nga legjislacioni shqiptar, Republika e Shqipërisë do të lëshojë një leje drejtimi shqiptare, pa provime, ose tarifa shtesë ose pa kërkuar dorëzimin ose depozitimin e lejes origjinale.

Me kërkesë të autoriteteve shqiptare, shtabi përkatës aleat jep miratimin për të konfirmuar që një individ është anëtar, person në ngarkim ose kontraktor në shtabin aleat.

2. Gjatë qëndrimit në Republikën e Shqipërisë, anëtarët dhe personat në ngarkim që përmbushin kërkesat ligjore sipas legjislacionit shqiptar, lejohen të marrin një leje drejtimi shqiptare pas përmbushjes së legjislacionit përkatës shqiptar.

3. Duke iu nënshtruar masave të mëtejshme, Republika e Shqipërisë asiston një shtab aleat në ngritjen dhe akreditimin e udhëzimeve, provimit të drejtuesit të mjetit dhe lejeve të drejtimit në Republikën e Shqipërisë.

Neni 28

Targat

1. Autoritetet shqiptare regjistrojnë automjetet dhe lëshojnë targat për automjetet dhe rimorkiot zyrtare të shtabit aleat dhe të automjeteve dhe rimorkiove në pronësi private të anëtarëve dhe personave në ngarkim të tyre, pavarësisht nga tipi i tyre, në pajtim me kushtet e përcaktuara në këtë Marrëveshje Shtesë.

2. Pa cenuar paragrafin 1, ose Marrëveshjen, neni XI, shtabi aleat, në pajtim me marrëveshjet e ardhshme me autoritetet kompetente shqiptare, ka të drejtë të bëjë regjistrimin e automjeteve dhe rimorkiove të veta zyrtare dhe të automjeteve dhe rimorkiove në pronësi private të anëtarëve dhe personave në ngarkim të tyre, pavarësisht nga tipi i tyre dhe duke marrë parasysh sa më poshtë:

a) Bazuar në marrëveshje të hollësishme, informacioni për regjistrimin e automjeteve hidhet në sistemin kombëtar shqiptar të regjistrimit dhe lëshohen përkatësisht targat. Autoritetet shqiptare e lehtësojnë këtë proces duke dhënë pajisjet e nevojshme dhe/ose akses për sistemet dhe vendndodhjet përkatëse.

b) Para lëshimit të një targe regjistrimi për automjetet dhe rimorkiot në pronësi private, shtabi aleat siguron që kërkesat e autoriteteve shqiptare në lidhje me sigurimin e detyruar të automjeteve, përjashtimet nga tatimet dhe zhdoganimi të përmbushen nga pronari.

c) Shtabi aleat, me kërkesë, informon autoritetet shqiptare doganore dhe të trafikut për të gjitha të dhënat në lidhje me importin, zhdoganimin dhe regjistrimin e automjeteve dhe rimorkiove në pronësi private.

4. Nëse një shtab suprem e konsideron thelbësore për shkaqe sigurie dhe si masë për mbrojtjen e forcës, Republika e Shqipërisë lëshon targa shtesë për automjetet dhe rimorkiot zyrtare dhe automjetet dhe rimorkiot në pronësi private, nëse kërkohet nga shtabi aleat. Përdorimi i targave shtesë nuk kuptohet si një heqje vullnetare dorë nga të drejtat dhe imunitetet e përcaktuara në nenet 7 dhe 17 të kësaj Marrëveshjeje Shtesë.

5. Regjistrimi dhe targat ofrohen falas për automjetet dhe rimorkiot zyrtare ndërsa regjistrimi në Shqipëri dhe lëshimi i targave për automjetet dhe rimorkiot në pronësi private dhe targat shtesë jepen vetëm sipas kostos faktike.

6. Asgjë në këtë nen nuk kuptohet sikur kundërshton ose pengon të drejtat e dhëna një shteti dërgues sipas Marrëveshjes, neni XI, për të importuar përkohësisht dhe rieksportuar automjetet e shërbimit me kushtet dhe sipas dokumentacionit të parashikuar në Marrëveshje.

Neni 29

Klubet ushtarake, koncesionet e udhëtimeve dhe komplekset sportive

Republika e Shqipërisë u siguron anëtarëve dhe personave në ngarkim të tyre akses në ngjarjet dhe klubet ushtarake, koncesionet dhe skontot e udhëtimeve, dhe komplekset sportive me të njëjtat kosto dhe norma që u ofrohen anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe

personave të varur të tyre.

Neni 30

Shërbimet mjekësore dhe dentare

Në pajtim me Marrëveshjen, neni IX, paragrafi 5, Republika e Shqipërisë u lejon anëtarëve dhe personave në ngarkim të tyre të marrin kujdes mjekësor dhe dentar, duke përfshirë shtrimin në spital, sipas kushteve të përcaktuara ose siç do të bihet dakord ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shtabit aleat ose shteteve dërguese, sipas rastit. Republika e Shqipërisë merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që të ekzistojnë dispozitat procedurale për të parandaluar vonesën ose mohimin e këtij kujdesi për shkak të mungesës së numrit personal ose të identifikimit shqiptar, regjistrimit ose një prove tjetër të statusit që normalisht përdoret nga shtetasit shqiptarë.

Neni 31

Shërbimet arsimore

1. Anëtarëve dhe personave në ngarkim të tyre u sigurohet akses në institucionet arsimore, duke përfshirë mësimin në gjuhën shqipe, që ofrohet nga autoritetet shqiptare (duke përfshirë autoritetet rajonale, bashkiake etj.), në të njëjtat kushte dhe sipas të njëjtave tarifa mësimore që zbatohen për qytetarët e Republikës së Shqipërisë.
2. Republika e Shqipërisë mbështet ngritjen e një shkolle ndërkombëtare në afërsi të shtabit aleat dhe siguron që kjo shkollë të marrë të njëjtat lehtësi dhe kushte që u jepen shkollave private në Republikën e Shqipërisë. Kjo mbështetje përfshin asistencën për të arritur akreditimin e kësaj shkolle nga agjencitë kombëtare dhe ndërkombëtare.
3. Një shtab aleat në Republikën e Shqipërisë është i autorizuar të ngrejë dhe operojë shkolla ndërkombëtare shtesë, ashtu siç mund të ngrihen shkolla të njësive kombëtare nga shtabi aleat dhe/ose njësitë kombëtare sipas kushteve dhe procedurave që përcaktohen më pas. Këto shkolla kanë rregullat dhe rregulloret e tyre në lidhje me të gjitha procedurat administrative dhe operative, duke përfshirë por pa u kufizuar te lëndët dhe kualifikimet e mësuesve. Këto shkolla janë të përshtatshme për të kërkuar mbështetje dhe lehtësira në pajtim me paragrafin 2 më sipër.
4. Republika e Shqipërisë njeh, vlerëson dhe certifikon diplomat e lëshuara nga shkollat e përmendura në paragrafët 2 dhe 3 të mësipërm, dhe lejon transferimin ose kalimin te të gjitha sistemet arsimore shqiptare, nga shkolla fillore te shkolla e mesme/gjimnazi dhe tek arsimi i lartë/universiteti.

Neni 32

Shërbimet e mirëqenies

1. Programet e moralit dhe mirëqenies të vendosura nga shtabi aleat në pajtim me rregulloret e NATO-s dhe nga njësitë kombëtare të mbështetjes autorizohen të angazhojnë anëtarët e shtabit dhe personat e varur të tyre në mbështetje të këtyre programeve, duke rimbursuar kostot përkatëse të tyre dhe kundrejt shpërblimit. Ky angazhim nuk përbën apo përputhet me punësimin dhe angazhimin, pavarësisht nga shtetësia e personave të përfshirë, nuk i nënshtrohet ligjeve shqiptare në lidhje me punën, punësimin, kontributet shoqërore etj., dhe rimbursimet dhe/ose shpërblimet përjashtohen nga çdo tatim në Republikën e Shqipërisë.
2. Në rastin kur një anëtar vdes ose largohet përfundimisht nga Republika e Shqipërisë, personat në ngarkim të këtij personi vazhdojnë të konsiderohen si persona të varur sipas kësaj Marrëveshjeje Shtesë për një periudhë deri në nëntëdhjetë (90) ditë pas kësaj vdekjeje ose transferimi, me kusht që personat në ngarkim të jenë të pranishëm në Republikën e Shqipërisë. Me kërkesën e një shtabi aleat, Republika e Shqipërisë kushton vëmendje pozitive për të zgjatur nëntëdhjetë (90) ditët deri në një (1) vit, me qëllim që t'u jepet mundësia personave në ngarkim të

përfundojnë një vit shkollor ose për shkak të rrethanave të tjera detyruese, që përcaktohen rast pas rasti.

3. Nëse shërbimet arsimore dhe sociale shqiptare përfshihen në çështjet në lidhje me anëtarët ose personat e varur, pa kërkesë paraprake të shtetit dërgues të tyre, njoftohet njësia (të) mbështetëse kombëtare e/të përfshirë/a ose shtabi aleat, sipas rastit.

Neni 33

Zbatimi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Palët bien dakord të marrin masat e kërkuara për të lehtësuar zbatimin dhe ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje Shtesë.

2. Të gjitha komunikimet dhe marrëveshjet e shkëmbyera ose të përfunduara në pajtim me këtë Marrëveshje Shtesë kryhen në gjuhët angleze ose frënge, të cilat njihen si gjuhët e vetme zyrtare të NATO-s.

3. Çdo mosmarrëveshje ose çështje që lind nga ekzekutimi i kësaj Marrëveshjeje Shtesë ndërmjet një Shtabi dhe Republikës së Shqipërisë, zgjidhet me bisedime në nivelin më të ulët të mundshëm dhe pa ia nënshtruar ndonjë procedure gjyqësore apo administrative, para se t'iu referohet palëve, palët bien dakord të zgjidhin së bashku çdo mosmarrëveshje ndërmjet tyre në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Shtesë, pa ia nënshtruar ndonjë procedure ose juridiksioni ligjor ose administrativ të jashtëm.

Neni 34

Kohëzgjatja dhe pushimi i fuqisë

1. Palët njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim pasi të jenë përmbushur procedurat e tyre të kërkuara për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Shtesë. Kjo Marrëveshje Shtesë hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit.

2. Kjo Marrëveshje Shtesë mbetet në fuqi pavarësisht nga prania e përhershme e një shtabi aleat në territorin e Shqipërisë.

3. Kjo Marrëveshje Shtesë mund të ndryshohet në çdo kohë me marrëveshje me shkrim të palëve. Shtojca bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje Shtesë mund t'i nënshtrohet rishikimit të veçantë; këto rishikime përfundohen si shkëmbim letrash ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Shtabit Suprem.

4. Kjo Marrëveshje Shtesë mund të zgjidhet nga secila palë pasi të ketë qenë në fuqi për dy vjet dhe mbetet në fuqi për dy vjet pas marrjes nga njëra prej palëve të njoftimit për zgjidhjen.

5. Pavarësisht nga sa më sipër, kjo Marrëveshje Shtesë mbetet në fuqi për dy vjet nga denoncimi efektiv dhe tërheqja nga protokolli nga ana e Republikës së Shqipërisë.

6. Pa cenuar Marrëveshjen, neni XV, dhe protokollin, neni 16, dhe në pajtim me dispozitat e paragrafit 6 më poshtë, kjo Marrëveshje Shtesë mbetet në fuqi në rastin e veprimeve ushtarake për të cilat zbatohet Traktati i Atlantikut Verior. Megjithatë, dispozitat në lidhje me vendndodhjen dhe numrin/fuqinë e personelit të një shtabi aleat, në rastin e këtyre veprimeve ushtarake, i nënshtrohen menjëherë shqyrtimit nga Shtabi Suprem përkatës dhe Republika e Shqipërisë, në mënyrë që çdo ndryshim i dëshiruar të bëhet në zbatim të kësaj Marrëveshjeje Shtesë. Për më tepër, neni 3, paragrafi 2, nuk zbatohet për transferimet e caktuara të nevojshme nga Republika e Shqipërisë në këto rrethana.

7. Në rastin e veprimeve ushtarake të përkufizuara më sipër, secila palë, pas një njoftimi prej 60 ditësh drejtuar palëve të tjera, ka të drejtë të pezullojë zbatimin e çdo dispozite, përveç nenit 33, të kësaj Marrëveshjeje Shtesë, në masën që mund të jetë e nevojshme. Nëse ushtrohet kjo e drejtë, palët konsultohen menjëherë me njëra-tjetrën në mënyrë që të arrihen masat mbi dispozitat e duhura

për të zëvendësuar ato për të cilat është pezulluar zbatimi.

Në dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, të autorizuar rregullisht, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje Shtesë

Bërë në

Në tri kopje, në gjuhën angleze

PËR (SACEUR/SACT)

Për Republikën e Shqipërisë

SHTOJCË

PËR MARRËVESHJEN NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTABIT SUPREM TË FORCAVE ALEATE NË EUROPË DHE SHTABIT TË KOMANDËS SUPREME TË ALEATËVE PËR TRANSFORMIMIN NË PLOTËSIM TË PROTOKOLLIT TË PARISIT

1. Një Shtab i Aleatëve i paraqet autoritetit të caktuar në Republikën e Shqipërisë Listat e Personelit që kanë të drejtat sipas kësaj Marrëveshjeje. Për hir të saktësisë, këto lista duhet t'i jepen autoritetit të caktuar çdo muaj.

2. Në pajtim me kontrollin, përdorimin dhe disponimin e caktuar në këtë Marrëveshje Shtesë dhe pa cenuar privilegjet e dhëna sipas Protokollit, neni 8, paragrafët 2 dhe 3, dhe Marrëveshjes, veçanërisht neni XI, paragrafët 5 dhe 6, anëtarët me të drejta dhe personat e varur të tyre gëzojnë të drejtat e mëposhtme në zbatim të nenit 17, të drejtat fiskale:

a.) Në pajtim me qëllimet e përcaktuara në Marrëveshje, neni XI, paragrafët 5 dhe 6, importimi i sendeve personale, mobilieve dhe automjeteve në pronësi private etj, si më poshtë:

1. Sendet personale dhe mobiliet: Gjatë gjashtë muajve pas mbërritjes së tyre, ose nëse ata mbërrijnë të pashoqëruar, gjashtë muaj pas mbërritjes së personit(ave) të tyre të fundit të varur, anëtarët me të drejta dhe personat e varur të tyre mund të importojnë sendet e tyre personale dhe mobiliet, të lirë nga çdo taksë dhe tatim për përdorim personal për afatin e këtij shërbimi. Pas mbarimit të afatit gjashtë-mujor, ata mund të importojnë gjithashtu, të lirë nga detyrimet ose tatimet, një dërgesë shtesë të sendeve personale dhe mobilieve. Në çdo rast dhe në çdo kohë, anëtarët me të drejta mund të zëvendësojnë, nëpërmjet importimit të lirë nga tatimet dhe detyrimet, sendet personale të humbura ose të dëmtuara ose mobiliet që janë importuar më parë të lira nga detyrimet ose tatimet. Këto artikuj, përfshirë sende të tjera personale të përftuara gjatë periudhës së shërbimit të NATO-s, mund të rieksportohen gjithashtu pa taksa dhe tatime.

2. Automjetet në pronësi private (duke përfshirë motoçikletat, karavanët): Anëtarët me të drejta, për afatin e shërbimit të tyre, mund të importojnë automjetet e tyre private për përdorim personal për veten e tyre dhe personat e varur të tyre, pavarësisht nga tipi, të lirë nga detyrimet dhe tatimet. Përkufizimi i motoçikletave është në pajtim me legjislacionin shqiptar.

3. Mjetet motorike të kohës së lirë (siç përkufizohen në legjislacionin shqiptar), rimorkiot dhe automjetet e kohës së lirë dhe kampingut: Anëtarët me të drejta për afatin e shërbimit të tyre mund të importojnë automjetet e tyre private të kohës së lirë dhe kampingut, pavarësisht nga tipi i tyre, të lirë nga detyrimet dhe tatimet, si pjesë e sendeve të tyre personale dhe mobilieve dhe për përdorim personal të tyre dhe personave të tyre të varur.

4. Pritja e pakove nëpërmjet sistemeve postare të Shtabit Suprem ose Shqipërisë, të lirë nga të gjitha detyrimet dhe tatimet, me kusht që përmbajtja të jetë për përdorim personal të tyre dhe personat e varur të tyre dhe që vlera totale e pakos të mos kalojë 100 euro.

b) Anëtarët me të drejta dhe personat e varur të tyre mund të blejnë sendet e identifikuar më poshtë në Republikën e Shqipërisë, të lirë nga tatimet dhe detyrimet. Tatimet dhe detyrimet shqiptare për këto blerje nuk mbahen ose rimbursohen në një procedurë që përcaktohet nga

Republika e Shqipërisë:

1) Sendet personale për përdorim privat në ekonominë shtëpiake të përditshme, kur vlera totale e mallrave sipas një fature kalon 64 euro. Një listë e hollësishme e sendeve përcaktohet ndërmjet Shtabit Suprem dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë.

2) Automjetet në pronësi private: jo më shumë se një automjet në pronësi private për person për familje/ekonomi shtëpiake mbi moshën e drejtimit të mjetit në Republikën e Shqipërisë.

3) Mjetet e kohës së lirë dhe kampingut: jo më shumë se një mjet për kohën e lirë ose kampingu për një anëtar me të drejta.

4) Karavanët: jo më shumë se një karvan për një anëtar me të drejta.

5) Rimorkiot: jo më shumë se një rimorkio për një anëtar me të drejta.

6) Motoçikletat (sipas përkufizimit në legjislacionin shqiptar): jo më shumë se një motoçikletë për person për familje/ ekonomi shtëpiake mbi moshën e drejtimit të mjetit.

7) Mjete të kohës së lirë (sipas përkufizimit në legjislacionin shqiptar): jo më shumë se një mjet të kohës së lirë për anëtar me të drejta.

3. Anëtarët dhe personat e varur të tyre mund të blejnë artikuj të racionuar në mensat e Shtabit Aleat në shumat që bihet dakord ndërmjet Shtabit Suprem dhe Ministrisë të Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë. Anëtarët dhe personat e varur të tyre mund të blejnë benzinë të lirë nga tatimet dhe karburant tjetër për mjetet motorike dhe motoçikletat në pronësi private; kjo është e kufizuar në 100-400 litra në muaj, në varësi nga madhësia motorike e mjetit të regjistruar ose motoçikletës dhe distanca midis banesës dhe punës e personit me të drejta.

4. Përjashtimet nga tatimet mbi importin ose blerjen e mjeteve në pronësi private, mjetet e argëtimit dhe kampingut, karavanët, rimorkiot, motoçikletat dhe varkat e kohë së lirë jepen deri në tre (3) muaj para se një anëtar me të drejta të hyjë në territorin shqiptar. Këto përjashtime lejohen vetëm gjatë gjashtë muajve të fundit të një periudhe në shërbimin ushtarak, me miratimin e arsyetuar të Shtetit dërgues ose të shtabit të aleatëve, sipas rastit.

5. Një shtab aleat përpilon rregullore të brendshme në lidhje me administrimin e blerjeve të bëra në mensën e shtabit të aleatëve për funksione zyrtare në atë shtab.

6. Asgjë në këtë Shtojcë nuk interpretohet sikur ndërhyn në tarifat doganore për kalimin e kufijve ndërkombëtarë, dhe është përgjegjësi individuale për të respektuar dhe përmbushur rregulloret doganore në fuqi.

7. Shumat e caktuara më sipër rishikohen çdo vit nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Shtesë dhe të përshtatura në pajtim me Indeksin Shqiptar të Çmimeve të Konsumatorit dhe të shkëmbyera veçmas ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe Shtabit Suprem.